



PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenkovic - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.P “CTA”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, ku është rekomanduar për kontratë OE “Al grup” SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 613-20-2452-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Lipjan”, më datën: 01.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N.P “CTA”SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 613-20-2452-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Lipjan”,

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës , për aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime” me nr. të prokurimit: 613-20-2452-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Lipjan”, si dhe **ANULOHET** në tërësi ky aktivitet i prokurimit, nëse edhe më tutje AK-ja ka interes për të vazhduar më këtë aktivitet të prokurimit, të njëjtin mund ta **Ritenderoj** konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.N.P "CTA"SH.P.K-Prishtinë, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës. në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.N.P "CTA"SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.12.2020 me nr. 1151/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në fshatin Gadime" me nr. të prokurimit 613-20-2452-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - "KK-Lipjan", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59, 60, 61, 65, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt. 11.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

OE NNP "CTA" SHPK - Prishtinë - ankues se AK – KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN

Pretendimi nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se AK ka shkelur Neni 1 të LPP-se Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. AK nuk ka respektuar neni 1 pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike në mënyrë efikase pasi që shpërblen me kontratë grupin e OE AL-GROUP SHPK DHE ARBERI-NS SHPK i cili kishte çmimit me të lartë në hapjen e tenderit d.m.th. çmimi fitues është 177,619.25EURO euro kurse oferta jonë ishte me çmim më të lirë ashtu siç është kërkuar në DT dhe njoftimin për kontratë oferta NNP"CTA"SHPK ishte me çmim 163,169.69 d.m.th. buxheti i shtetit është dëmtuar për 14,009.56 euro ose në përqindje 8.13 % me e lartë se oferta jonë që ishte më e lirë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron se autoriteti kontraktues respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve ka respektuar LPP-ne përkatësisht nenin 1 Qëllimi sepse në bazë të komisionit për vlerësim kanë shpërblye me kontrate sipas vlerësimit të tyre OE të përgjegjshëm me çmimin më të ultë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar

Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se ky tender ka qen valid deri me datë 21.09.2020 kurse AK ka kërkuar me vonës zgjatjen e validitetit të tenderit d.m.th. ka kërkuar me datë 22.09.2020 dëshminë e keni në e-prokurim,

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim sqaron: Në bazë të dosjes së tenderit të shpallur për aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i çerdhës së fëmijëve në Fshatin Gadime , me nr. të prokurimit: 613 – 20 – 2452 -5-2-1 , Periudha vlefshmërisë së tenderit ne baze te nenit 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 60 ditë; Afati i fundit i dorëzimit të tenderit ne baze te neni 23.1 Afati i fundit për dorëzim është 23.06.2020 14:00:00, Në bazë të kësaj vlefshmëria e tenderit nga data 23.06.2020 plus 60 dite Periudha e vlefshmërisë është deri me datën 22.08.2020, AK-ja ka bërë kërkesës OE për zgjatjen e validitetit të ofertës për 30 ditë, me datën 22.09.2020 dhe ka kërkuar: "Konfirmimin se pajtoheni për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sipas kërkesës së AK duhet të dërgohet përmes Platformës elektronike të e-prokurimit respektivisht Dërgimi i dokumentit për Autoritetin kontraktues më së largu deri më 24.09.2020". Kërkesat për vazhdim të vlefshmërisë nga Operatoret Ekonomik janë pranuar më datën 22.09.2020 Siç po shihet nga data 22.08.2020 deri me datën 22.09.2020 afati i periudhës së validitetit të tenderëve ka qen i pa mbuluar .

AK-ja ka bërë kërkesë për herën e dytë Operatoreve Ekonomik për vazhdimin e validitetit të ofertës për 30 ditë, me datën 19.11.2020 dhe ka kërkuar : "Konfirmimin per vazhdimin e validitetit te oferte se tenderit do ta dërgoni përmes Platformës elektronike të e-prokurimit deri më datën 20/11/2020 ne ora 15" Eksperti shqyrtues mendon se AK ka shkëlur nenin 31.4 TE RROUP-se Nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit) 31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të

gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues Punëtorët Xhemajl MORINA, ARBNOR KRASNIQI, Haxhi MORINA dhe Fatmir MORINA kanë para kontratë me OE të shpallur fitues ku këta janë punëtorë të kompanisë projektuese ARHIKO ING me pronar SHEFQET MORINA.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim respektivisht Certifikatë-at e dorëzuara nga OE për z. Xhemajl MORINA, z. Arbnor KRASNIQI, z. Haxhi MORINA dhe z. Fatmir MORINA, në bazë të këtyre Certifikatave për të cilat OE ankues ka pretendime këta persona kanë zhvilluar trajnim për pune praktike në Kompaninë NNP. "Arhiko Ing" në Prishtinë nga data 03.09.2012 deri me 02.12.2012 dhe janë aftësuar për profesionin e caktuar i cili program është organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me I.O.M , Eksperti Shqyrtues mendon se ky nuk është konflikt interesi sepse trajnimi është zhvilluar në vitin 2012 kurse PARAKONTRATA PËR PUNË PËR PROJEKTE TË CAKTUARA është lidhur në vitin 2020 afërsisht 8 vite difference dhe sipas certifikatës së fituar ka qenë trajnim i drejtpërdrejt në pune praktike. Dhe njëherit pretendimi se OE "Arhiko Ing" ka Kontratë Publike Kornize me Komunën e Lipjanit për "Hartimin e projekteve detale " Eksperti shqyrtues sqaron se personat për të cilët OE –ankues ka pretendime se këta punëtor të kësaj kompanie kanë marr pjesë në hartimin e projekteve detale eksperti shqyrtues mendon se këta persona nuk janë stafe profesionale dhe nuk kanë përgatitje profesionale shkollore (arsim superior) për hartimin e projekteve detale sepse përgatitja e tyre shkollore nuk përkon me përgatitje të kërkuar për hartimin e projekteve. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 4

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se OE i shpallur fitues për menaxheren Lendita MEKULI ka dorëzuar CV, në emër të LENDITA MYNDERIZI po ashtu edhe CV është në gjuhën angleze nuk është në gjuhën shqipe siç është dorëzuar komplet dosja.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim Diplomën e fakultetit të përfunduar si dhe CV-në e dorëzuar me ofertë sqaron se Menaxherja e projektit Lendita MEKULI e caktuar nga grupi i operatorëve ekonomik të shpallur fitues, z. Lendita, mbiemrin MEKULI e ka mbiemër të vajzërisë kurse mbiemrin

Myderrizi te kurorëzimit te martesës. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 5

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se OE i shpallur fitues për GJEODETIN ka dorëzuar *DIPLOMA NE EMER TE HATIXHE REXHA *LICENCA në emër të HATIXHE HOXHA *CV NE EMER TE HATIXHE REXHAJ HOXHA Nga këto 3 dokumente të dorëzuara asnjëra nuk korrespondon me tjetrën CV në mbiemër Rexhaj nuk e plotëson kërkesën për gjeodet in sepse CV është për tjetër person.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim per z. HATIXHE REXHA sqaron se z. Hatixhe ka dorëzuar Diplomë-n e emër të HATIXHE SEFER REXHA e lindur në PRIZREN MË 29 QERSHOR 1985, LICENCA në emër të HATIXHE HOXHA, ndërsa CV-ja – Informatat personale në emër të HATIXHE REXHAJ –HOXHA, pretendimi i OE ankues është te mbiemri ne i vajzërisë i shënuar ne CV-in. Eksperti shqyrtues mendon se ky është një gabim minor d.m.th. Gabim në drejtshkrim mbiemrit (sa për ilustrim të këtij gabimi minor po marrim pretendimin ankimor nr. 4 të OE ankues NNP "CTA" ku mbiemrin e z. Lindita MYDERRIZI e shënon MYNDERIZI, pra e shton shkronjën N dhe në vend të shkronjës RR e shënon shkronjën R.) Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Pretendimi nr. 6

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë – ankues se sa i përket eliminimit tone nga aktiviteti i prokurimit nga komisioni vlerësues Dhe pikat e cekura në letrën standarde për eliminim te datës 08.12.2020 AK eliminim ynë është e pakuptim sepse ka sqaruar ne letrën standarde se çka ma konkretisht jemi eliminua andaj nuk kemi pasur si te përgjigjemi .

Kemi dy vendime për këtë lëndë nga OSHP 506/20 DHE 784-824/20 dhe në dy vendimet për pikat e njëjta nuk janë dhënë mendime të njëjta Vendimi nr. 506/20 ku paneli shqyrtues sqaron qe AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 te LPP të kërkoj informatë shtesë për menaxherin.

Përgjigje në Pretendimin nr. 6

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin qe kam pranuar në shqyrtim sqaron se bazuar ne Vendimin PSH nr. 506 / 20 19.07.2020 ne te cilin thuhet

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezultojnë se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si e bazuar, të ANULOHET Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezultojnë se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si e bazuar, të ANULOHET Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik N.N.P "CTA" SH.P.K- Prishtinë me datë 14.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 21.01.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së sepse qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. AK nuk ka respektuar neni 1 pasi nuk ka shfrytëzuar fondet publike në mënyrë efikase pasi që shpërblen me kontratë grupin e OE AL-GROUP SHPK DHE ARBERI-NS SHPK i cili kishte çmimit me të lartë në hapjen e tenderit d.m.th. çmimi fitues është 177,619.25EURO euro, kurse oferta jonë ishte me çmim më të lirë ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, oferta NNP "CTA" SHPK ishte me çmim 163,169.69 euro, d.m.th. buxheti i shtetit është dëmtuar për 14,009.56 euro ose në përqindje 8.13 % me e lartë se oferta jonë që ishte më e lirë.

Paneli Shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues sqaron se autoriteti kontraktues, respektivisht komisioni për vlerësim të tenderëve ka respektuar LPP-në përkatësisht nenin 1 (Qëllimi) sepse në bazë të komisionit për vlerësim kanë shpërblye me kontratë sipas vlerësimit të tyre OE të përgjegjshëm me çmimin më të ultë. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se ky tender ka qenë valid deri me datë 21.09.2020, kurse AK ka kërkuar me vonesë zgjatjen e validitetit të tenderit d.m.th. ka kërkuar me datë 22.09.2020 dëshminë e keni në e-prokurim.

Paneli Shqyrtues sqaron se në bazë të dosjes së tenderit të shpallur për aktivitetin e prokurimit: Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Fshatin Gadime me nr. të prokurimit: 613 – 20 – 2452 -5-2-1, periudha vlefshmërisë së tenderit në bazë të nenit 21.1 Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 60 ditë; Afati i fundit i dorëzimit të tenderit në bazë të nenit 23.1 Afati i fundit për dorëzim është 23.06.2020 ora 14:00:00, Në bazë të kësaj vlefshmërie e tenderit nga data 23.06.2020 plus 60 ditë periudha e vlefshmërisë është deri me datën 22.08.2020, AK-ja ka bërë kërkesës OE për zgjatjen e validitetit të ofertës për 30 ditë, me datën 22.09.2020 dhe ka kërkuar: "Konfirmimin se pajtoheni për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës sipas kërkesës së AK duhet të dërgohet përmes Platformës elektronike të e-prokurimit respektivisht Dërgimi i dokumentit për Autoritetin kontraktues më së largu deri më 24.09.2020". Kërkesat për vazhdim të vlefshmërisë nga Operatoret Ekonomik janë pranuar më datën 22.09.2020. Siç po shihet nga data 22.08.2020 deri me datën 22.09.2020 afati i periudhës së validitetit të tenderëve ka qenë i pa mbuluar. AK-ja ka bërë kërkesë për herën e dytë operatorëve ekonomik për vazhdimin e validitetit të ofertës për 30 ditë, me datën 19.11.2020 dhe ka kërkuar: "Konfirmimin për vazhdimin e validitetit të ofertës së tenderit do ta dërgoni përmes Platformës elektronike të e-prokurimit deri më datën 20/11/2020 në ora 15". Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka shkelur nenin 31.4 të RROUPP-së, ku është përcaktuar se nën situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkojë nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetit të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohej para datës së skadimit (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit) 31.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohej që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se punëtorët Xhemajl Morina, Arbnor Krasniqi, Haxhi Morina dhe Fatmir Morina kanë para kontratë me OE të shpallur fitues, ku këta janë punëtorë të kompanisë projektuese ARHIKO ING me pronar Shefqet Morina.

Paneli Shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga OE ankues sqaron se Certifikatë-at e dorëzuara nga OE për z. Xhemajl Morina, z. Arbnor Krasniqi, z. Haxhi Morina dhe z. Fatmir Morina, në bazë të këtyre certifikatave për të cilat OE ankues ka pretendime këta persona kanë zhvilluar trajnim për punë praktike në kompaninë NNP "Arhiko Ing" në Prishtinë nga data 03.09.2012 deri me 02.12.2012 dhe janë aftësuar për profesionin e caktuar, i cili program është organizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me I.O.M. Paneli Shqyrtues konsideron se ky nuk është konflikti interesi sepse trajnimi është zhvilluar në vitin 2012 kurse para kontrata për punë për projekte të caktuara është lidhur në vitin 2020, afërsisht 8 vite difference dhe sipas certifikatës së fituar ka qenë trajnim i drejtpërdrejt në punë praktike. Dhe njëherit, pretendimi se OE "Arhiko Ing" ka kontratë publike kornize me Komunën e Lipjanit për "Hartimin e projekteve detale", Paneli Shqyrtues sqaron se personat për të cilët OE ankues ka pretendime se këta punëtor të kësaj kompanie kanë marr pjesë në hartimin e projekteve detale, këta persona nuk janë staf profesional dhe nuk kanë përgatitje profesionale shkollore (arsim superior) për hartimin e projekteve detale sepse përgatitja e tyre shkollore nuk përkon me përgatitje e kërkuar për hartimin e projekteve. Andaj, ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se OE i shpallur fitues për menaxheren Lendita Mekuli ka dorëzuar CV në emër të Lendita Mynderizi, po ashtu edhe CV është në gjuhën angleze, nuk është në gjuhën shqipe siç është dorëzuar komplet dosja.

Paneli Shqyrtues sqaron se diploma e fakultetit të përfunduar si dhe CV-në e dorëzuar me ofertë e menaxheres së projektit Lindita Mekuli, e caktuar nga grupi i operatorëve ekonomik të shpallur fitues, z. Lindita me mbiemrin Mekuli, e ka mbiemër te vajzërisë kurse mbiemrin Myderrizi të kurorëzimit të martesës. Prandaj, bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK Prishtinë, se OE i shpallur fitues për gjeodetin ka dorëzuar diplomën në emër të Hatixhe Rexha, licenca në emër të Hatixhe Hoxha, CV në emër të Hatixhe Rexhaj Hoxha. Nga këto 3 dokumente të dorëzuara asnjëra nuk korrespondon me tjetrën CV në mbiemër Rexhaj dhe nuk e plotëson kërkesën për gjeodetin sepse CV është për tjetër person.

Paneli Shqyrtues sqaron se z. Hatixhe ka dorëzuar Diplomën në emër të Hatixhe Sefer Rexha, e lindur në Prizren, më 29 Qershor 1985, Licenca në emër të Hatixhe Hoxha, ndërsa CV-ja – Informatat personale në emër të Hatixhe Rexhaj –Hoxha. Pretendimi i OE ankues është te mbiemri i vajzërisë, i shënuar në CV-in, ku Paneli Shqyrtues konsideron se ky është një gabim minor d.m.th. gabim në drejtshkrim mbiemrit. Ky gabim është i ngjashëm sikurse te pretendimi ankimor që ka të bëjë me mbiemrin e z. Lindita MYDERRIZI, e shënon MYNDERIZI, pra e shton shkronjën N dhe në vend të shkronjës RR e shënon shkronjën R.. Prandaj,

ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar mirëpo nuk paraqet ndryshim material apo ndonjë ndryshim në rezultatin përfundimtar.

Lidhur me pretendimin e OE NNP "CTA" SHPK-Prishtinë, se sa i përket eliminimit tonë nga aktiviteti i prokurimit nga komisioni vlerësues dhe pikat e cekura në letrën standarde për eliminim të datës 08.12.2020, eliminimi ynë është i pakuptimt sepse ka sqaruar në letrën standarde se çka ma konkretisht jemi eliminuar andaj nuk kemi pasur si të përgjigjemi. Kemi dy vendime për këtë lëndë nga OSHP 506/20 dhe 784-824/20, dhe në dy vendimet për pikat e njëjta nuk janë dhënë mendime të njëjta Vendimi nr. 506/20 ku paneli shqyrtues sqaron që AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP të kërkoj informatë shtesë për menaxherin.

Paneli Shqyrtues për këtë pretendim ankimor sqaron se në vendimin PSH.nr.506/20 të datës 19.07.2020 është konstatuar se AK ka mundur që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së. Kurse, në vendimin PSH.nr.784-824/20 të datës 16.11.2020 është konstatuar "Pra, ky pretendim është shqyrtuar më parë me vendimin PSH.nr.506/20 të dt. 17.09.2020, në bazë të cilit Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka mundur konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së të kërkoj informata shtesë."

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve dhe analizës konkrete, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar zgjatjen e validitetit të ofertave në sipas pikës 31 të RRUOPP-së. Dhe, në këto rrethana, Paneli Shqyrtues konsideron se ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në bazë të nenit 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran MIŁENKOVIC

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Lipjan";
- 1x1 OE N.N.P "CTA"SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.